

GRATË DHE BURRAT NË MAQEDONINË E VERIUT **2025**



GRATË DHE BURRAT NË MAQEDONINË E VERIUT, 2025

Gratë dhe burrat në Maqedoninë e Veriut, 2025

Botues: Enti Shtetëror i Statistikës

Dame Gruev 4, Shkup
Republika e Maqedonisë së Veriut
tel.: +389 (0)2/3295-600
faks: +389 (0)2/3111-336
Faksi postar 506

Përgjegjës: Dejan Stankov, drejtor

Redaktor: Tatjana Gjorgjievska

Titulli i originalit: Жените и мажите во Северна Македонија, 2025

Përktheu nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe: BesTel

Dizajn: Nita Haxhihamza Gashi

Shtypur në: Poliesterdej, Shkup

Tirazhi: 100 kopje

Numri i faqeve: 103

Viti i publikimit: 2025

Kur përdorni të dhënat, citoni burimin:

Enti Shtetëror i Statistikës i Republikës së Maqedonisë së Veriut (2025) "Gratë dhe burrat në Maqedoninë e Veriut"

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

31:314.117-055.1/.2(497.7)"2025"
314.117-055.1/.2(497.7)"2025"

GRATË dhe burrat në Maqedoninë e Veriut : 2025 / [redaktor Tatjana Gjorgjievska]. - Shkup : Enti shtetëror i statistikës, 2025. - 103 стр.; 20 x 20 см

Превод на делото: Жените и мажите во Северна Македонија : 2025

ISBN 978-608-227-361-7

а) Население -- Полова структура -- Македонија -- 2025 -- Статистика

COBISS.MK-ID 66045701



Zhvillimi dhe shtypja e këtij publikimi u mbështet në kuadër të programit të UN Women "Promovimi i qeverisjes së përgjegjshme gjinore në Republikën e Maqedonisë së Veriut" financuar nga Suedia. Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht opinionet dhe pikëpamjet e UN Women, Kombeve të Bashkuara ose organizatave të tjera të lidhura, ose Suedisë si donatore.

PËRMBAJTJA

Shkurtesat	4
Parathënie	5
Ngjyrjet kryesore në legjislacionin dhe politikën e barazisë gjinore në Maqedoninë e Veriut	6
1. POPULLSIA	11
2. SHËNDETËSIA	33
3. ARSIMI DHE KOMUNIKIMI	41
4. PJESËMARRJA EKONOMIKE	63
Struktura e të ardhurave	79
5. MBROJTJA SOCIALE	83
6. PUSHTETI DHE VENDIMMARRJA	89
7. KRIMI DHE DREJTËSIA	95

SHKURTESAT

AFP	Anketa e Fuqisë Punëtore
EShS	Enti Shtetëror i Statistikës
BE	Bashkimi European
Konventa e Stambollit	Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje
TIK	Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit
PKV	Plani Kombëtar i Veprimit
KB	Kombet e Bashkuara
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
ShTF	Shkalla totale e fertilitetit
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
GREVIO	Trupi ekspert i Këshillit të Evropës për zbatimin e Konventës së Stambollit
NEET	Persona që nuk janë të punësuar dhe nuk ndjekin arsim ose trajnim
UN Women	Enti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave

Të nderuar përdorues,

Statistikat gjinore luajnë një rol kyç në formësimin e politikave dhe iniciativave që synojnë arritjen e barazisë gjinore. Ato ofrojnë dëshmi empirike që kontribuojnë për marrjen e vendimeve, i nxjerrin në pah dallimet dhe e ndjekin progresin me kalimin e kohës. Enti Shtetëror i Statistikave (ESHS) ka qenë në krye të mbledhjes, analizimit dhe shpërndarjes së të dhënave të ndara sipas gjinisë në vendin tonë, duke nxitur kështu një kuptim më të thellë të dinamikës midis grave dhe burrave në sektorë të ndryshëm.

Që nga fillimi i tij në vitin 2000 e deri më sot, botimi “Gratë dhe Burrat në Maqedoninë e Veriut” ka shërbyer si një gur themel, duke ofruar njohuri mbi karakteristikat demografike, arsimore dhe ekonomike të popullsisë. Ky edicion i katërmëdhjetë e vazhdon traditën e ofrimit të të dhënave statistikore gjithëpërfshirëse dhe të përditësuara, gjë që e reflekton angazhimin e ESHS-së për ruajtjen e vazhdimësisë së të dhënave, njëkohësisht duke prezantuar tregues të rinj që i pasqyrojnë tendencat dhe sfidat e reja.

Bashkëpunimi ndërmjet ESHS-së dhe UN Women ishte kyç për përmirësimin e cilësisë dhe shtrirjes së statistikave gjinore në vend. Ky partneritet siguron që të dhënat jo vetëm që u përmbahen standardeve ndërkombëtare, por i adresojnë edhe nevojat specifike të peizazhit politik të vendit. Treguesit e prezantuar u mundësojnë palëve të interesuara ta monitorojnë efektivitetin e iniciativave për barazi gjinore dhe t’i identifikojnë fushat për të cilat është e nevojshme ndërhyrje e mëtejshme.

Duke shqyrtuar tendencat në arsim, punësim, shëndetësi dhe vendimmarrje, ky botim ofron një këndvështrim të nuancuar mbi progresin dhe ngecjet në punën për barazi gjinore. Ai shërben si një mjet thelbësor për hartuesit e politikave, studiuesit dhe avokuesit që janë të përkushtuar për krijimin e një shoqërie të barabartë, ku mundësitë dhe rezultatet nuk përcaktohen nga gjinia.

I ftojme lexuesit të përfshihen në të dhënat e prezantuara, të reflektojnë mbi hapat e ndërmarrë dhe ta njohin punën që ka mbetur për t’u bërë. Vetëm përmes analizave të bazuara në informacion dhe përpjekjeve të përbashkëta mund të vazhdojmë të përparojmë drejt një të ardhmeje ku barazia gjinore është realitet i gjallë për të gjithë qytetarët tanë.

Drejtori
Dr. Dejan Stankov

ZHVILLIMET KRYESORE NË ASPEKT TË LEGJISLACIONIT DHE POLITIKËS PËR BARAZI GJINORE NË MAQEDONINË E VERIUT

1991	Aderimi në Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) dhe nënshkrimi i Protokollit Fakultativ që hyri në fuqi në vitin 2003
1995	Nënshkrimi i Deklaratës së Pekinit dhe Platformës për Veprim, të miratuara në Konferencën e Katërt Botërore për Gratë në Pekin
1997	Miratohet Vendimi për themelimin e Njesisë për Avancimin e Barazisë Gjinore në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale.
1999	Miratohet Plani i parë Kombëtar i Veprimit për Barazinë Gjinore
2001	Futet kuota gjinore, e cila kërkon që 30% e kandidatëve në listat zgjedhore në nivel kombëtar dhe lokal të jenë nga gjinia më pak e përfaqësuar.
2003	Themelohet Klubi i Deputeteve - një grup joformal dhe ndërpartiak i deputeteve nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut.
2005	Miratohet Ligji për Marrëdhëniet e Punës, me dispozita për mbrojtje nga diskriminimi dhe mundësi të barabarta për gratë dhe burrat
2006	- Miratohet Ligji për Mundësitë e Barabarta për Gratë dhe Burrat - Në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut themelohet Komisioni për Mundësi të Barabarta të Grave dhe Burrave - Kuota gjinore për zgjedhjet është zgjeruar dhe kërkon që çdo i treti në listat e kandidatëve të jetë nga gjinia më pak e përfaqësuar.
2007	- Njësia për Avancimin e Barazisë Gjinore në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale (1997) u riorganizua dhe u shndërrua në Sektor për Mundësi të Barabarta, duke e avancuar kështu statusin e tij dhe duke i dhënë përgjegjësi të përgjithshme për avancimin e statusit të grave dhe burrave në të gjitha sferat e jetës shoqërore. - Emërohen koordinatore për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat në të gjitha institucionet në nivel qendror dhe lokal - Miratohet Plani i dytë Kombëtar i Veprimit për Barazinë Gjinore për periudhën 2007 – 2012.

2010	• Miratohet Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi • Miratohet Strategjia për Amësinë e Sigurt për periudhën 2010-2015, me PKV për zbatimin e saj
2011	• Miratohet Strategjia për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues për periudhën 2011-2020, me PKV për zbatimin e saj
2012	• Miratohet Strategjia për Buxhetim të Përgjegjshëm Gjinator (2012 – 2017) • Miratohet PKV-ja e parë për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Gratë, Paqja dhe Siguria (2013 – 2015). • Për herë të parë në Maqedoninë e Veriut, miratohet një Ligj për Rrogën Minimale – ai nuk i referohet në mënyrë eksplicite grave, por i mbulon vendet e punës me rrogë të ulët ku mbizotërojnë gratë.
2013	• Miratohet Strategjia e parë për Barazinë Gjimore për periudhën 2013-2020 • Miratohet Ligji për Ndërprerjen e Shtatzënisë (Ligji për Abortin) – me të cilin kufizohet qasje e grave në abort
2014	• Miratohet Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje • Prezantohet koncepti i buxhetimit të përgjegjshëm gjinator (BPGJ) dhe zbatohet për herë të parë në institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale.
2015	• Ndryshime dhe plotësime në Kodin Zgjedhor, me të cilat rritet kuota gjimore nga 30% në 40% e përfaqësimit të gjinisë më pak të përfaqësuar të kandidatëve në listat zgjedhore. • Ndryshime dhe plotësime në Ligjin për Marrëdhëniet e Punës – me të cilat kërkohet rrogë e barabartë për gratë dhe burrat dhe trajtim i barabartë për sa i përket punësimit, orarit të punës, kushteve të punës, skemave për sigurim social dhe mungesës nga puna
2017	• Miratohet Ligji për Ratifikimin e Konventës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) (e cila është nënshkruar në vitin 2011 dhe ka hyrë në fuqi në vitin 2018) • Ndryshime dhe plotësime në Ligjin për Rrogën Minimale – për të barazuar rrogën minimale me mesataren kombëtare për punëtorët në industrinë e tekstilit, të lëkurës dhe të këpucëve, ku shumica e të punësuarve janë gra.

2018	• Miratohet Plani i tretë Kombëtar i Veprimit për Barazinë Gjinore për periudhën 2018 – 2020. • Miratohet PKV 2018 - 2023 për zbatimin e Konventës së Stambollit - për harmonizimin e legjislacionit kombëtar me dispozitat e Konventës, si dhe përmbushjen e detyrimeve për parandalimin e dhunës me bazë gjinore, sigurimin e mbrojtjes efektive të viktimave dhe ndjekjen penale dhe ndëshkimin e autorëve • Ndryshime në Metodologjinë për Planifikimin Strategjik dhe Përgatitjen e Programit Vjetor të Punës së Qeverisë – të cilat kontribuuan në krijimin e një mekanizmi për përfshirjen e perspektivës gjinore në planet strategjike dhe programet vjetore dhe monitorimin e zbatimit të tyre • Miratohet Strategjia për Zhvillimin e Sipërmarrjes së Grave 2019 - 2023 - me qëllim të zhvillimit të një ekosistemi sipërmarrës për avancimin e vazhdueshëm të sipërmarrjes së grave, përmes përfshirjes së të gjitha palëve të interesuara relevante, rritjes së numrit të ndërmarrjeve fillestare (start-up) në pronësi të grave, rritjes së numrit të punonjësve në kompani të themeluara nga gratë dhe rritjes së numrit të grave të punësuara nëpër kompani. • Miratohen ndryshimet në Ligjin për Tekstet Shkollore për Arsimin Fillor dhe të Mesëm – për të kufizuar përmbajtjet diskriminuese dhe me stereotipe në tekstet shkollore dhe për të garantuar cilësi • Miratohen ndryshime në Ligjin për Arsimin Fillor – me të cilat u fut një dispozitë kundër diskriminimit
2019	• Miratohet Ligji i ri për Ndërprerjen e Shtatzënësisë (Ligji për Abortin) – me të cilin u shfuqizuan dispozitat për periudhën e këshillimit të detyrueshëm dhe barrierat e tjera administrative për ushtrimin e të drejtës për abort. • Miratohet Ligji i ri për Mbrojtjen Sociale - reforma e sistemit të gjithëmbarshtëm të mbrojtjes sociale për të përmbushur në mënyrë më efektive nevojat e qytetarëve, me ç'rast gratë dhe vajzat nga kategoritë e cënueshme zënë një vend veçanërisht të rëndësishëm
2020	• Miratohet Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi – me të cilin njihet identiteti gjinor dhe orientimi seksual si bazë për diskriminim dhe futet koncepti i diskriminimit ndërsektorial • Miratohet Plani i dytë Kombëtar i Veprimit për Zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së (2020 – 2025)

2021	• Miratohet Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje - i harmonizuar me kërkesat e Konventës së Stambollit
2022	• Miratohet Strategjia e re për Barazinë Gjinore 2022-2027, e cila përmban qëllime të përgjithshme dhe specifike të përcaktuara qartë, rezultate të pritura dhe tregues për monitorim dhe vlerësim • Dorëzohet Raporti i parë nga Maqedonia e Veriut në GREVIO - organi ekspert i Këshillit të Evropës për zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje - Konventës së Stambollit. • Miratohet Ligji për Buxhetet, me të cilin për herë të parë rregullohet parimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor dhe detyrimi për të përfshirë treguesit gjinorë dhe një deklaratë buxhetore gjinore në nivel qendror dhe lokal • Miratohet propozim-ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, me të cilin ulet përqindja për shitjen e produkteve menstruale. • Një qendër burimesh për politikëbërje dhe buxhetim të përgjegjshëm gjinor është hapur nga Ministria e Politikave Sociale, Demografisë dhe Rinisë, në partneritet me zyrën e UN Women në Maqedoninë e Veriut.
2023	• Miratohen ndryshimet në Kodin Penal për të njohur më shumë lloje të dhunës me bazë gjinore, si përndjekja, ngacmimi seksual, dhuna ekonomike etj. • Ratifikimi i Konventës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës për Eliminimin e Dhunës dhe Ngacmimit në Botën e Punës, Nr. 190
2024	• Gordana Siljanovska-Davkova u zgjodh presidentja e parë grua e Republikës së Maqedonisë së Veriut • Formohet Komisioni Shtetëror për Kompensimin e Viktimave të Veprave Penale të Dhunës, i cili ofron mbrojtje më të madhe për viktimat e dhunës që lidhet me dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore, veprat penale që e cenojnë integritetin seksual, trafikimin e qenieve njerëzore dhe lloje të tjera të dhunës.



POPULLSIA

Sipas të dhënave nga Regjistrimi i fundit i Popullsisë, Amvisërive dhe Banesave në vitin 2021, Republika e Maqedonisë së Veriut ka 1.836.713 banorë, që është për 5.6% më pak se sa në Regjistrimin e Popullsisë të vitit 1994 dhe 9.2% më pak se në Regjistrimin e Popullsisë të vitit 2002.

Përqindja e pjesëmarrjes së grave dhe burrave në totalin e popullsisë është pothuajse e barabartë, por për herë të parë në Regjistrimin e Popullsisë të vitit 2021, pjesëmarrja e grave me 50.4% është më e lartë se pjesëmarrja e burrave (49.6%). Kjo e dhënë mbështet edhe treguesin për numrin e burrave për 1000 gra, i cili është 984.3 burra për 1000 gra.

Duke e parë situatën sipas grupmoshave, në grupmoshën nga 0 deri në 14 vjeç numri i burrave është për 6.7% më i lartë se numri i grave, në grupmoshën nga 15 deri në 64 vjeç numri i burrave është vetëm për 0.7% më i lartë se numri i grave dhe në grupmoshën nga 65 vjeç e lart numri i grave është për 16.8% më i lartë se numri i burrave. Është kuriozitet se në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë regjistruar edhe 51 persona mbi moshën 100 vjeçare, prej të cilëve 33 janë gra dhe 18 burra.

Në vend dominon popullsia urbane me gjithsej 1.131.356 banorë (ose 61.6%), ndërsa në zonat rurale jetojnë 705.357 banorë (ose 38.4%). Pjesëmarrja e grave në zonat rurale është 37.5% e numrit të përgjithshëm të grave, kurse e burrave 39.3% e numrit të përgjithshëm të burrave.

Sipas Regjistrimit të Popullsisë të vitit 2021, numri i personave me aftësi të kufizuara në totalin e popullsisë rezidente është 94.412, nga të cilët 55.3% janë gra.

Sipas Regjistrimit të Popullsisë të vitit 2021, sipas llojit të familjes, nga gjithsej 538.348 familje, 10.1% janë nëna të vetme me fëmijë, kurse 3.2% janë baballarë të vetëm me fëmijë.

Sipas të dhënave nga Vlerësimi i fundit i Popullsisë, gjendja më 30.06.2023, Republika e Maqedonisë së Veriut ka 922 015 gra dhe 905 801 burra, kurse përqindja e pjesëmarrjes së grave dhe burrave është pothuajse e barabartë, gjegjësisht 50.4% janë gra dhe 49.6% janë burra. Domethënë, numri i meshkujve në 1000 gra në vitin 2023 është 982.4.

Sa i përket strukturës së moshës, popullsia e Maqedonisë po plaket gjithnjë e më shumë dhe sot është në një gjendje të pleqërisë demografike. Plakja e kombit konfirmohet edhe nga të dhënat sipas grupmoshave, ku numri i të moshuarve është në rritje, e gjithashtu edhe pjesëmarrja e tyre në totalin e popullsisë. Sipas Vlerësimit të Popullsisë në vitin 2023, pjesëmarrja e popullsisë së moshës 0-14 vjeç është 16.7%, e moshës 15-64 vjeç është 65.4%, kurse pjesëmarrja e popullsisë së moshuar të moshës 65 vjeç e lart është 17.9%.

Treguesit demografikë në nivel rajonal tregojnë dallime që vënë në dukje pabarazi në shpërndarjen territoriale të popullsisë. Më i dendur është rajoni i Shkupit, kurse më pak i populluar është ai i Vardarit.

Për sa i përket pjesëmarrjes së popullsisë mashkullore në krahasim me popullsinë femërore sipas rajoneve, vetëm tre rajone kanë përqindje më të lartë të popullsisë mashkullore, përkatësisht Rajoni i Vardarit me 50.3%, Rajoni Juglindor me 50.1% dhe Rajoni Verilindor me 50.2%.

Në dekadat e fundit, Republika e Maqedonisë së Veriut është përballur me sfida të shumta që dalin nga kushtet ekzistuese ekonomike dhe sociale, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë mbi popullsinë. Ndërkohë që përqindjet e lindjeve po zvogëlohen, dhe si rrjedhojë po zvogëlohet edhe pjesëmarrja e të rinjve në strukturën e përgjithshme të popullsisë, numri i të moshuarve po rritet gjithnjë e më shumë.

Në vitin 2023, mosha mesatare e popullsisë është 41.2 vjeç (42.1 vjeç për gratë dhe 40.3 vjeç për burrat). Sipas jetëgjatësisë së pritur në Republikën e Maqedonisë së Veriut, gratë jetojnë 77.6 vjet, ose 4,4 vjet më shumë se burrat, të cilët jetojnë 73.2 vjet.

Sipas vlerës së shkallës totale të fertilitetit (TFR) në vitin 2023, që është 1.5 lindje të fëmijëve të gjallë për një grua, gratë në Maqedoninë e Veriut gjithnjë e më shumë vendosin të lindin vetëm 1 fëmijë.

Mosha mesatare e nënës, në vitin 2023, për numrin total të lindjeve është 29.6 vjeç, ndërsa te nënat që lindin për herë të parë është 28.1 vjeç. Në vitin 2023 janë regjistruar 14 lindje të fëmijëve të gjallë nga nënat nën moshën 15 vjeç.

Sipas rendit të lindjes, 7387 ose 44.1% janë fëmijë të parë, 6191 ose 37.0% janë të lindur të dytë, 2099 janë të lindur të tretë (12.5%), dhe janë regjistruar edhe 11 raste të fëmijëve të gjallë të lindur si të nëntit ose 0.1% e më shumë.

Sipas strukturës gjinore të lindjeve të fëmijëve të gjallë, meshkujt kanë një pjesëmarrje më të madhe prej 50.9%, gjegjësisht në 100 lindje të fëmijëve të gjallë, 103.6 janë djem.

Struktura e pafavorshme e moshës ka ndikim edhe në numrin e personave të vdekur. Në vitin 2023, nga gjithsej 20.187 persona, 47.3% janë gra dhe 52.7% janë burra. Moshë mesatare e të vdekurve të gjinisë mashkullore është 72.1 vjeç, gjegjësisht 76.5 vjeç te personat e gjinisë femërore, ose për 4.4 vjet moshë mesatare më e lartë është regjistruar te gratë.

Në vitin 2023, në numrin e përgjithshëm të rasteve të vdekjeve të dhunshme (412), pjesëmarrje më të madhe kanë “rastet e fatkeqësive” me 69.9%, ku gratë marrin pjesë me 28.5%, “vetëvrasjet” me 25.2%, nga të cilët 25% janë gra dhe “vrasjet” me 4.9%, nga të cilët 20.0% janë gra. Në numrin e përgjithshëm të personave të vdekur në fatkeqësitë e transportit, pjesëmarrja e burrave është dukshëm më e madhe me 80.0%.

Si rezultat i shtyrjes së martesës në vitet e mëvonshme të jetës, në vitin 2023 shumica e martesave kanë ndodhur në grupmoshën nga 25 deri në 29 vjeç, gjegjësisht 4.228 ose 33.4% te gratë dhe 4.450 ose 35.1% te burrat.

Moshë mesatare në martesën e parë është 27.5 vjeç për nusen dhe 30.1 vjeç për dhëndrin. Më e shpeshtë është martesa e parë, me një përqindje të pjesëmarrjes prej 93.2% për gratë dhe 92.2% për burrat. Burrat kanë më shumë gjasa të martohen për herë të dytë, me një pjesëmarrje prej 7.0%, dhe për herë të tretë, me një përqindje prej 0.8%, në numrin e përgjithshëm të martesave.

Sipas moshës, numri më i madh i divorceve ka ndodhur në grupmoshën nga 35 deri në 39 vjeç, nga të cilat 310 ose 17.6% te burrat dhe 295 ose 17.6% te burrat. Sipas kohëzgjatjes së martesës, më së shumti divorce 393 ose 22.3% kanë ndodhur nga 5 deri në 9 vjet pas martesës.

Të dhënat për migrimin e brendshëm tregojnë se pjesëmarrjen më të madhe, me 48,0%, e kanë gratë e grupmoshës 30-64 vjeç. Sipas të dhënave për qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut të cilët kanë emigruar në vende tjera në vitin 2023, nga gjithsej 2.034 persona, pjesëmarrja e grave është 47.5%.

PËRKUFIZIME

Rritja natyrore e popullsisë - dallimi midis numrit të lindjeve të fëmijëve të gjallë dhe numrit të personave të vdekur për një periudhë të caktuar kohore.

Shkalla e natalitetit - paraqet raportin ndërmjet numrit të lindjeve të fëmijëve të gjallë dhe numrit mesatar të popullsisë në mesin e vitit për të cilin është llogaritur, e llogaritur në 1.000 banorë.

Shkalla e rritjes natyrore - tregon ndryshimin midis lindjeve të fëmijëve të gjallë dhe numrit të personave të vdekur në raport me numrin mesatar të popullsisë në mesin e vitit për të cilin është llogaritur, e llogaritur në 1.000 banorë.

Shkalla e përgjithshme e lindshmërisë - tregon numrin mesatar të mundshëm të lindjeve të fëmijëve të gjallë që një grua nga brezi i vëzhguar do t'i lindte në periudhën pjellore (15-49 vjeç), në kushtet e ndikimit të njëjtë të përqindjeve specifike të lindshmërisë, si edhe në vitin e vëzhguar, pa ndikimin e vdekshmërisë.

Shkalla e vdekshmërisë - tregon raportin e numrit të personave të vdekur gjatë gjithë vitit me numrin mesatar të popullsisë (në mes të vitit) për atë vit, e llogaritur për 1.000 banorë.

Shkalla e vdekshmërisë perinatale, paraqet shumën e lindjeve të fëmijëve të vdekur dhe vdekjeve të fëmijëve të lindur si të gjallë gjatë javës së parë të jetës për 1.000 lindje të fëmijëve të gjallë në vitin e njëjtë kalendarik.

Shkalla e vdekshmërisë neonatale, përkufizohet si raport i numrit të rasteve të vdekjeve të fëmijët në periudhën e foshnjërisë, gjegjësisht në periudhën në 28 ditët e para pas lindjes për 1.000 lindje të fëmijëve të gjallë në vitin e njëjtë kalendarik.

Vdekshmëria perinatale dhe vdekshmëria neonatale - përdoret për të matur cilësinë e mbrojtjes shëndetësore, gjegjësisht të kujdesit antenatal, kujdesit perinatal dhe postnatal, të cilat janë pjesë e tre niveleve të mbrojtjes shëndetësore (primare, sekondare dhe terciare).

Martesa është një bashkim jetësor i një burri dhe një gruaje i rregulluar me ligj, në të cilin realizohen interesat e bashkëshortëve, familjes dhe shoqërisë.

Martesa e divorcuar është martesa e zgjidhur me aktgjykim të formës së prerë nga gjykata kompetente.

Migrimet e brendshme i përfshijnë ndryshimet e vendbanimit brenda Republikës së Maqedonisë.

Migrimet e jashtme i përfshijnë lëvizjet e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë nga Republika e Maqedonisë në një shtet tjetër dhe anasjelltas, si dhe lëvizjet e të huajve.

Bilanci i migrameve të popullsisë paraqet ndryshimin ndërmjet numrit të personave të ardhur dhe numrit të personave të larguar në një territor ose shtet të caktuar në një periudhë të caktuar.

Shkalla e nupcialitetit - tregon raportin midis numrit të martesave të lidhura gjatë një viti dhe numrit të popullsisë në mesin e vitit të njëjtë, e llogaritur për 1.000 banorë.


Shkalla e divorcialitetit - tregon raportin midis numrit të martesave të divorcuara gjatë një viti dhe numrit të popullsisë në mesin e vitit të njëjtë, e llogaritur për 1.000 banorë.

Vlerësimi i popullsisë: Numri dhe struktura e moshës-gjinore e popullsisë përcaktohet me regjistrimet e popullsisë. Megjithatë, periudha dhjetëvjeçare e regjistrimeve të popullsisë paraqet një periudhë shumë të gjatë në të cilën ndodhin ndryshime të rëndësishme si rezultat i lëvizjes natyrore dhe mekanike të popullsisë, si në numrin e përgjithshëm të popullsisë, ashtu edhe në strukturën e saj të moshës-gjinore. Prandaj, bazuar në të dhënat e regjistrimeve të popullsisë dhe të dhënat për lëvizjen natyrore dhe mekanike të popullsisë, për vitet ndërmjet regjistrimeve të popullsisë përgatiten vlerësime të popullsisë.

Shkalla e përgjithshme e koeficientit të varësisë në bazë të moshës tregon raportin midis numrit të fëmijëve (0-14 vjeç) dhe atyre të moshës 65 vjeç e lart, në raport me popullsinë në moshë pune (15-64). Treguesi paraqet raportin ndërmjet numrit total të personave të moshës 0-14 vjeç, kur janë kryesisht ekonomikisht joaktivë, dhe numrit të personave të moshës 65 vjeç e lart.



GRAFIKU 1.

Treguesit e strukturës gjinore të popullsisë nëpër regjistrimet e popullsisë, 1931-2021




GRAFIKU 2.

Numri i burrave për 1000 gra në Regjistrimet e Popullsisë të viteve 1994, 2002 dhe 2021




GRAFIKU 3.

Popullsia sipas moshës dhe gjinisë sipas regjistrimeve të popullsisë në 1994, 2002 dhe 2021.




GRAFIKU 4.

Pjesëmarrja e grave dhe burrave sipas grupmoshave bazë, Regjistrimi i Popullsisë 2021.



GRAFIKU 5.

Struktura e popullsisë sipas rajoneve, sipas gjinisë, Regjistrimi i popullsisë në vitin 2021



Rajoni	Gjinia	Gjithsej	%
Rajoni i Vardarit	Gjithsej	138 722	100
	Gra	68 847	49.6
	Burra	69 875	50.4
Rajoni Lindor	Gjithsej	150 234	100
	Gra	75 123	50.0
	Burra	75 111	50.0
Rajoni Jugperëndimor	Gjithsej	177 398	100
	Gra	89 033	50.2
	Burra	88 365	49.8
Rajoni Juglindor	Gjithsej	148 387	100
	Gra	73 982	49.9
	Burra	74 405	50.1

Rajoni	Gjinia	Gjithsej	%
Rajoni i Pellagonisë	Gjithsej	210 431	100
	Gra	105 449	50.1
	Burra	104 982	49.9
Rajoni i Pollogut	Gjithsej	251 552	100
	Gra	127 375	50.6
	Burra	124 177	49.4
Rajoni Verilindor	Gjithsej	152 982	100
	Gra	76 140	49.8
	Burra	76 842	50.2
Rajoni i Shkupit	Gjithsej	607 007	100
	Gra	309 677	51.0
	Burra	297 330	49.0

GRAFIKU 6.

Vlerësimi i popullsisë, sipas moshës dhe gjinisë, gjendja më 30.06.2023




TABELA 1.
Mosha mesatare e popullsisë

Burra		Gra
39.9	2021	41.7
40	2022	41.9
40.3	2023	42.1



TABELA 2.
Jetëgjatësia e pritur

Burra		Gra
72.4	2019-2021	76.8
72.2	2020-2022	76.7
73.2	2021-2023	77.6

TABELA 3.
Popullsia totale rezidente sipas llojit të aftësisë së kufizuar, grupmoshave dhe gjinisë,
Regjistrimi i popullsisë në vitin 2021

Lloji i paaftësisë	Gjinia	Grupmoshat			
		Gjithsej	0-14	15-65	65+
Gjithsej	Gjithsej	94 412	1 674	40 985	51 753
	Gra	52 203	661	20 415	31 127
	Burra	42 209	1 013	20 570	20 626
Me lëvizjen	Gjithsej	38 499	258	13 597	24 644
	Gra	23 021	121	6 859	16 041
	Burra	15 478	137	6 738	8 603
Me shikimin	Gjithsej	12 371	307	5 678	6 386
	Gra	6 917	157	3 090	3 670
	Burra	5 454	150	2 588	2 716
Me dëgjimin	Gjithsej	5 947	69	1 419	4 459
	Gra	2 906	29	666	2 211
	Burra	3 041	40	753	2 248
Me komunikimin	Gjithsej	3 896	385	2 193	1 318
	Gra	1 670	106	841	723
	Burra	2 226	279	1 352	595
Vështirësi të tjera	Gjithsej	33 699	655	18 098	14 946
	Gra	17 689	248	8 959	8 482
	Burra	16 010	407	9 139	6 464

TABELA 4.

Lindjet e fëmijëve të gjallës sipas moshës dhe statusit martesor të nënës

	2021		2022		2023	
	E martuar	Jashtë martese	E martuar	Jashtë martese	E martuar	Jashtë martese
Gjithsej	16 102	2 546	15 775	2 298	14 681	2 056
Nën 15 vjeç	-	20	-	17	-	14
15-19	311	480	272	433	215	369
20-24	2 645	670	2 636	587	2 291	498
25-29	5 685	649	5 432	571	5 026	491
30-34	4 992	454	4 894	405	4 609	385
35-39	2 074	207	2 091	204	2 087	226
40-44	376	61	410	72	414	61
45-49	13	3	34	6	34	9
50 +	6	2	6	3	5	2
E panjohur	-	-	-	-	-	1

GRAFIKU 7.

Struktura e lindjeve të fëmijëve të gjallë sipas moshës së nënës




TABELA 5.
Lindjet e fëmijëve të gjallë sipas moshës së nënës, qytet/fshat

	2021		2022		2023	
	Qytet	Fshat	Qytet	Fshat	Qytet	Fshat
Gjithsej	11 772	8 073	10 866	7 207	10 171	6 566
Nën 15 vjeç	15	1	12	5	7	7
15-19	511	387	428	277	351	233
20-29	5 442	4 890	4 904	4 322	4 443	3 863
30-39	5 454	2 665	5 148	2 446	4 966	2 341
40-49	343	130	368	154	397	121
50 +	7	-	5	3	5	1
E panjohur	-	-	1	0	2	-

TABELA 6.
Mosha mesatare e nënës gjatë lindjes,
gjithsej dhe në fëmijën e parë

Gjithsej lindje		Lindja e parë
29.2	2021	27.5
29.4	2022	27.7
29.6	2023	28.1

GRAFIKU 8.

Shkalla e përgjithshme e lindshmërisë





GRAFIKU 9. Indeksi vital - Lindjet e fëmijëve të gjallë në 100 vdekje




TABELA 7. Mortaliteti

Shkalla e mortalitetit	
2021	15.5
2022	12.3
2023	11.0

Shkalla e foshnjave të vdekura	
2021	2.9
2022	1.4
2023	0.9

Shkalla e vdekshmërisë perinatale	
2021	9.3
2022	6.9
2023	7.6

Shkalla e vdekshmërisë neonatale	
2021	4.6
2022	3.2
2023	1.8

Shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve nën 5 vjeç

2021	4.9
2022	3.8
2023	2.4

TABELA 8.

Foshnja të vdekura në moshë foshnjërie sipas moshës

	Gjithsej	Deri 24 orë	1-6 ditë	7 - 29 ditë	1 - 3 muaj	4 - 6 muaj	7-11 muaj
2021	85	12	19	23	17	8	6
2022	58	9	6	12	16	10	5
2023	30	3	5	7	7	5	3

TABELA 9.

Të vdekur, qytet/fshat

	2021			2022			2023		
	Gjithsej	Gra	Burra	Gjithsej	Gra	Burra	Gjithsej	Gra	Burra
Gjithsej	28 516	13 361	15 155	22 459	11 868	10 591	20 187	10 640	9 547
Qytet	17 955	8 259	9 696	14 354	7 514	6 840	12 724	6 657	6 067
Fshat	10 561	5 102	5 459	8 105	4 354	3 751	7 463	3 983	3 480

GRAFIKU 10.

Mosha mesatare e të vdekurve




TABELA 10.

Persona të vdekur nga vdekjet e dhunshme

	2021		2022		2023	
	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra
Gjithsej	258	419	132	354	112	300
Raste fatkeqësie	225	339	107	275	82	206
Vetëvrasje	32	73	24	74	26	78
Vrasje	1	7	1	5	4	16
Në %	100	100	100	100	100	100
Raste fatkeqësie	87.2	80.9	81.1	77.7	73.2	68.7
Vetëvrasje	12.4	17.4	18.2	20.9	23.2	26
Vrasje	0.4	1.7	0.8	1.4	3.6	5.3

GRAFIKU 11.

Persona të vdekur fatkeqësi transporti



GRAFIKU 12.
Martesat e lidhura sipas moshës




TABELA 11.

Martesa e parë e lidhur e nuses sipas moshës, nën 20 vjeç

Moshë e nuses	Martesa e parë		
	2021	2022	2023
16	23	32	26
17	46	40	39
18	447	349	336
19	519	443	391
Gjithsej	1 035	864	792

TABELA 12.

Martesa e parë e lidhur e dhëndrit sipas moshës, nën 20 vjeç

Moshë e dhëndrit	Martesa e parë		
	2021	2022	2023
16	2	1	2
17	6	3	2
18	54	50	47
19	109	120	102
Gjithsej	171	174	153

TABELA 13.

Moshë mesatare në martesën e parë

Gra		Burra
27.0	2021	29.8
27.1	2022	29.9
27.5	2023	30.1



TABELA 14.

Martesa të lidhura sipas statusit të mëparshëm martesor

Statusi i mëparshëm martesor	Gra	Burra
2021		
E pamartuar/I pamartuar	12 531	12 437
Vejushë/Vejan	59	89
E divorcuar/I divorcuar	747	811
2022		
E pamartuar/I pamartuar	12 065	12 001
Vejushë/Vejan	71	109
E divorcuar/I divorcuar	746	772
2023		
E pamartuar/I pamartuar	11 813	11 687
Vejushë/Vejan	85	136
E divorcuar/I divorcuar	774	849

TABELA 15.

Martesa të lidhura sipas radhës së martesës

Martesa me radhë	Gra	Burra
2021		
E parë	12 531	12 437
E dytë	777	825
E tretë e më shumë	29	75
2022		
E parë	12 065	12 001
E dytë	785	811
E tretë e më shumë	32	70
2023		
E parë	11 813	11 687
E dytë	813	882
E tretë e më shumë	46	103

TABELA 16.

Divorcet sipas moshës së bashkëshortëve

	Gruaja		Burri		Gruaja		Burri	
	2021		2022		2023			
Gjithsej	1 964		1 613		1 765			
Nën 20	14	1	14	3	14	2		
20 – 24	160	72	126	52	151	68		
25 – 29	307	207	252	178	262	211		
30 – 34	354	330	298	281	314	289		
35 – 39	364	365	269	268	310	295		
40 – 44	274	308	239	273	273	268		
45 – 49	199	242	183	205	189	235		
50 +	292	439	232	353	252	397		

TABELA 17.

Divorci sipas kohëzgjatjes së martesës

Kohëzgjatja në vite	Viti		
	2021	2022	2023
Gjithsej	1 964	1 613	1 975
Nën 1 vjet	91	72	79
1	137	113	143
2	149	90	114
3	115	98	111
4	102	110	121
5-9	451	360	393
10-14	276	230	248
15+	643	540	556

GRAFIKU 13.

Divorcet sipas fëmijëve të ndarë pas divorcit (%)




TABELA 18.

Treguesit bazë për martesat e lidhura dhe divorcet

Viti	Shkalla e nupcialitetit (martesa të lidhura në 1.000 banorë)	Shkalla e divorcialitetit (divorce në 1.000 banorë)	Divorce në 1.000 martesa të lidhura
2021	7.3	1.1	147.3
2022	7.0	0.9	125.2
2023	6.9	1.0	139.3

GRAFIKU 14.

Familjet sipas llojit të familjes, Regjistrimi i popullsisë në vitin 2021




TABELA 19.

Migrimet e brendshme Qytetarë të ardhur, sipas gjinisë dhe moshës,

	Maqedonia e Veriut	Shkup	Maqedonia e Veriut	Shkup	Maqedonia e Veriut	Shkup
	2021		2022		2023	
Gjithsej	6 407	1 999	6 377	2 342	6 220	2 005
0-14	2	0	8	2	23	2
15-29	2 786	591	2 609	698	2 372	543
30-64	3 182	1 279	3 288	1 461	3 350	1 321
65+	437	129	472	181	475	139
Gra	4 593	1 167	4 554	1 393	4 412	1 231
0-14	2	0	4	2	9	0
15-29	2 409	409	2 230	487	2 039	390
30-64	1 976	696	2 087	820	2 114	765
65+	206	62	233	84	250	76
Burra	1 814	832	1 823	949	1 808	774
0-14	0	0	4	0	14	2
15-29	377	182	379	211	333	153
30-64	1 206	583	1 201	641	1 236	556
65+	231	67	239	97	225	63

TABELA 20.

Qytetarë të ardhur sipas gjinisë, sipas rajoneve


	Gjithsej	Burra	Gra	Gjithsej	Burra	Gra	Gjithsej	Burra	Gra
	2021			2022			2023		
Maqedonia e Veriut	3 381	1 019	2 362	3 628	1 133	2 495	3 542	1 094	2 448
I Vardarit	262	53	209	244	48	196	236	45	191
Lindor	272	57	215	241	57	184	284	71	213
Jugperëndimor	314	94	220	359	116	243	381	132	249
Juglindor	263	73	190	252	55	197	248	66	182
I Pellagonisë	240	55	185	208	49	159	258	62	196
I Pollogut	258	44	214	224	48	176	238	39	199
Verilindor	220	45	175	197	38	159	180	30	150
I Shkupit	1 552	598	954	1 903	722	1 181	1 717	649	1 068

Shënim: Të dhënat i referohen numrit total të imigrantëve dhe emigrantëve në Republikën e Maqedonisë të Veriut, por nuk përfshijnë imigrantët dhe emigrantët në të njëjtin rajon.

TABELA 21.

Të migruar në vende të tjera sipas gjinisë dhe moshës, sipas rajonit

		RMV		I Vardarit		Lindor		Jugperëndimor		Juglindor		I Pellagonisë		I Pollogut		Verilindor		I Shkupit	
		Qytetarë të RMV	Të huaj	Qytetarë të RMV	Të huaj	Qytetarë të RMV	Të huaj	Qytetarë të RMV	Të huaj	Qytetarë të RMV	Të huaj	Qytetarë të RMV	Të huaj	Qytetarë të RMV	Të huaj	Qytetarë të RMV	Të huaj	Qytetarë të RMV	Të huaj
2021																			
0-14	M	60	6	7	0	14	0	3	0	1	2	1	3	5	0	6	0	23	1
	G	61	4	6	0	14	0	6	0	1	0	1	1	7	0	6	1	20	2
15-29	M	218	33	33	1	20	0	54	3	13	1	7	7	26	2	5	0	60	19
	G	176	19	31	0	15	0	40	2	16	0	3	6	34	6	4	0	33	5
30-64	M	321	100	56	2	22	0	45	20	24	0	25	19	63	0	7	2	79	57
	G	334	17	46	0	15	0	43	0	37	1	17	5	64	1	13	1	99	9
65+	M	26	1	1	0	0	0	1	0	1	0	1	0	12	0	0	0	10	1
	G	34	2	2	0	0	0	10	0	3	0	1	0	11	0	2	0	5	2
2022																			
0-14	M	79	31	3	0	28	0	4	2	0	2	0	1	7	1	0	0	37	25
	G	86	33	4	0	26	0	6	1	0	0	0	0	9	0	2	0	39	32
15-29	M	248	92	27	5	26	0	53	11	7	0	1	6	41	5	2	0	91	65
	G	220	36	29	0	18	0	47	0	6	1	1	1	34	7	2	1	83	26
30-64	M	624	231	83	7	62	0	76	39	23	12	3	6	117	3	6	0	254	164
	G	488	41	55	0	29	1	82	1	21	2	0	1	88	3	4	1	209	32
65+	M	84	3	1	0	1	0	20	2	1	0	0	0	29	0	1	0	31	1
	G	76	2	4	0	2	0	10	0	2	0	0	0	35	0	0	0	23	2
2023																			
0-14	M	104	6	32	0	26	0	5	0	0	1	0	2	9	0	0	0	32	3
	G	113	10	27	0	42	0	3	0	0	1	0	7	2	0	3	0	36	2
15-29	M	285	80	61	2	23	0	74	3	11	3	0	17	44	0	2	3	70	52
	G	242	14	59	0	21	0	70	0	13	1	0	2	27	2	1	1	51	8
30-64	M	624	201	116	7	46	0	114	29	39	4	0	27	131	4	2	0	176	130
	G	541	30	119	0	38	0	124	2	40	1	0	12	87	3	3	0	130	12
65+	M	55	2	11	0	3	0	8	1	3	0	0	0	7	0	0	0	23	1
	G	70	0	8	0	3	0	11	0	1	0	0	0	11	0	0	0	36	0



SHËNDETËSIA

Në vitin 2023, nga numri i përgjithshëm i personave të vdekur, 47.3% janë gra. Pjesëmarrje më të madhe kanë personat e vdekur nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut me 8836 persona, nga të cilët 50.6% janë gra, pasuar nga rastet në të cilat neoplazma është shkaku i vdekjes, nga të cilët 40% janë gra. Shkalla e vdekshmërisë nga sëmundjet kronike është dukshëm më e lartë tek burrat sesa tek gratë. Numri i përgjithshëm i vetëvrasjeve është pothuajse i njëjtë, por ato janë një shkak më i shpeshtë i vdekjes te burrat.

Të dhënat nga fusha e shëndetit seksual dhe riprodhues tregojnë se shkalla e aborteve ka rënë nga 17.1 aborte në 100 lindje të fëmijëve të gjallë në vitin 2021 në 13.2 në vitin 2023. Gjatë së njëjtës periudhë ka rënë ndjeshëm edhe numri i aborteve tek gratë e moshës mbi 35 vjeç.

Mesatarisht në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën 2013 deri 2022 ka 7217 raste të reja kanceri në nivel vjetor, gjegjësisht në 100.000 banorë ka 374.78 raste. 53.8% e rasteve janë burra, ndërsa 46.2% janë gra. Deri në moshën 50 vjeçare gratë janë të përfaqësuara me 61.82%, ndërsa burrat me 38.2%. Në moshën mbi 50 vjeç, burrat janë të përfaqësuar me 55.9% për dallim nga gratë, të cilat janë të përfaqësuara me 44.1%.

Rreth 88% të rasteve të kancerit janë në mesin e popullatës e cila është më e vjetër se 50 vjet, nga të cilët ndërmjet 50 dhe 60 vjet janë 18.2%. Rreth 0,1% të rasteve të kancerit paraqiten te fëmijët dhe adoleshentët më të ri se 15 vjet.

Diagnoza më e zakonshme te popullata femërore është neoplazma malinje e gjirit me 25,1%.

PËRKUFIZIME

Person i vdekur është çdo person i lindur i gjallë që ka përjetuar ndërprerje të përhershme të të gjitha funksioneve jetësore

Aborti - ndërprerja e shtatzënisë

Kanceri është një emër gjithëpërfshirës për më shumë se njëqind sëmundje të ndryshme që ndodhin në rastin e rritjes së pakontrolluar të qelizave për shkak të defekteve në mekanizmin normal të punës së trupit tonë.

TABELA 1.


Persona të vdekur sipas shkaqeve të vdekjes¹

	2021			2022			2023		
	Gjithsej	Burra	Gra	Gjithsej	Burra	Gra	Gjithsej	Burra	Gra
Gjithsej	28 516	15 155	13 361	22 459	11 868	10 591	20 187	10 640	9 547
Sëmundje të sistemit të qarkullimit të gjakut	10 238	5 054	5 184	9 284	4 555	4 729	8 836	4 369	4 467
Neoplazma	3 931	2 336	1 595	3 809	2 227	1 582	3 747	2 249	1 498
Simptoma, shenja dhe rezultate jonormale klinike, të paklasifikuara diku tjetër	2 521	1 335	1 186	2 960	1 582	1 378	2 804	1 497	1 307
KOVID-19	5 888	3 384	2 504	1 532	944	588	1 449	637	812
Sëmundje të sistemit të frymëmarrjes	1 192	663	529	1 002	558	444	943	560	383
Sëmundje endokrine, të ushqyerjes dhe metabolizmit	1 661	694	967	1 507	693	814	909	374	535
Sëmundje të sistemit nervor	1 074	466	608	958	416	542	515	275	240
Sëmundje të sistemit uro-gjenital	517	279	238	463	250	213	350	252	98
Lëndime, helmime dhe disa pasoja të tjera të shkaqeve të jashtme	677	419	258	486	354	132	119	77	42
Sëmundje të sistemit të tretjes	600	398	202	311	213	98	412	300	112
Tjetër	217	127	90	147	76	71	103	50	53

¹ Klasifikimi ndërkombëtar statistikor i sëmundjeve dhe problemeve të lidhura me shëndetin, Rishikimi i 10-të

GRAFIKU 1.

